



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Në pajtim me nenin 132 dhe me nenin 133 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 33 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe me Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) shpall:

KONKURS PUBLIK
për
Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Titulli i vendit të punës:	Ekspert (një)
Numri i referencës:	1/2019 - MSHV
Niveli i pagesës së shërbimit:	I negociuar
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MShV)
Kohëzgjatja e marrëveshjes:	Dy muaj kalendarikë

Eksperti për ngritjen e kapaciteteve institucionale do të ofrojë asistencë teknike, ta mbështesë dhe ta ndihmojë menaxhmentin dhe Grupin e Punës së IAP-së në rishikimin dhe në plotësimin e rregulloreve të brendshme:

1. Përgatitjen dhe zhvillimin e modulit për Grupin e Punës në temat: “Ridizajnimi i strukturave organizative, proceset, hapat dhe mekanizmat anësorë të zbatueshëm që duhen ndërmarrë”, dhe “Teknikat legjislative dhe normëzimi i politikave të Burimeve Njerëzore në kontekst të ndryshimeve organizative, rregullave dhe proceseve të punës në IAP”.
2. Rishikimin e Rregullores nr. 01/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në IAP.
3. Rishikimin e Rregullores nr. 02/2016 të Punës për IAP-në.
4. Rishikimin e Rregullores nr. 01/2017 për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit e Institucionit të Avokatit të Popullit.
5. Rishikimin e Rregullores nr. 02/2017 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuere për Nëpunësit e Institucionit të Avokatit të Popullit.
6. Rishikimin e Rregullores nr. 03/2017 për Avancimin në Karrierë dhe Transferimin e Nëpunësve të Institucionit të Avokatit të Popullit.
7. Pjesëmarrja në Punëtori të Grupit të Punës lidhur me trajtimin, shqyrtimin dhe finalizimin e dokumenteve të përgatitura, të rishikuara dhe të plotësuara, siç janë nënvizuar në pikët si më sipër.

Kualifikimet dhe përvoja:

Kandidati për Ekspert për ngritje të kapaciteteve institucionale duhet të ketë:

- Përgatitje universitare për drejtësi ose për administratë publike, diploma Master është e dëshirueshme.
- Së paku 10 vjet përvojë pune profesionale përkatëse me detyrat e kërkuara.
- Njohuri të shkëlqyeshme lidhur me mandatin kushtetues dhe ligjor të Avokatit të Popullit në sferën e promovimit, të mbrojtjes dhe të mbikëqyrjes së drejtave të njeriut.
- Aftësi të mira në konceptimin dhe hartimin e politikave të veprimit, në hartimin e dokumenteve dhe të akteve ligjore nga fushëveprimtaria e institucioneve publike, me theks të posaçëm, të Institucionit të Avokatit të Popullit.
- Eksperiencë specifike në zbatimin e teknikave legjislative, në hartimin dhe/apo ripërshkrimin e detyrave të punës, përcaktimin dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit, të gradimit, të avancimit dhe të transferimit të personelit, si dhe në zhvillimin e moduleve të trajnimeve në

fushat përkatëse të rishikuara të IAP-së.

- Aftësi të larta analitike, komunikimi, shkrimi dhe aftësi të raportimit.
- Aftësi të larta kompjuterike (Windows, MS Office, Internet Explorer).
- Aftësi të shkëlqyeshme të punës në ekipe me staf menaxherial dhe profesional.
- Gatishmëri për t'i përmbushur detyrat brenda kohës së paraparë për kryerjen e shërbimit, me cilësi të lartë dhe me efektivitet, si dhe të jetë person me integritet të lartë profesional dhe personal.
- Njohje të shkëlqyeshme, në të folur dhe të shkruar, të gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës.
- Certifikatën e Numrit Fiskal nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Kandidati i interesuar për Ekspert duhet t'i paraqesë po ashtu:

- Kornizën e Planit Operacional të Punës në zbatim të detyrave/punëve sipas termave të referencës.
- Biografinë profesionale (CV).

Kohëzgjatja e kontratës:

- 2 muaj

Çmimi (kostoja e shërbimit):

- I negociuar

Kushtet për pjesëmarrje në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë të veprimit, përgatitjen e kërkuar arsimore si dhe aftësinë profesionale në kryerjen e detyrave përkatëse.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Divizioni për Burime Njerëzore, zyra nr. 4, kati II, ndërtesa e ish-Bankës të Lubjanës, me nr. 21, Rr. "Migjeni"; 10000 Prishtinë, ose mund të shkarkohen në ueb-faqen www.oik-rks.org.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendrike nga dita e publikimit, përkatësisht nga **data 23 korrik 2019 deri më 30 korrik 2019**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkohen si më lart për këtë vend të punës.

Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë, nëpërmjet telefonit.